

Në bazë të nenit 116, paragrafi (1) të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/15) dhe nenit 23, paragrafi (1), pika 2 nënpika 1 të Statutit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 01-391/2, datë 26 gusht 2011 dhe nr.01-374/6, datë 19 mars 2019, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 12 tetor 2021, miratoi

VENDIM

për hedhjen poshtë të kërkesës për përsëritjen e procedurës

1. Kërkesa për përsëritjen e procedurës PA1 12-141/21, datë 13 gusht 2021, e dërguar nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë “CMM ENERGJI KOMPANI” SHPKNJP eksport-import Shkup, HIDHET POSHTË si e pabazuar ligjërisht.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij, ndërsa do të botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PA1 12–141/21

12.10.2021

Shkup

**Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës
dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut**

Марко Бислимоски